



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.200/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Fejzullah Rexhepi dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Valbona Millaku Foniqi, duke vendosur përkritazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosjes (LVV), paraqitur kundër koalicionit AAK/PSD, me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së tavolinës me material propagandues dhe postera në rrugë për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 05.10.2019, mori këtë:

## VE N D I M

**Pranohet** ankesa A.nr.200/2019 e datës 03.10.2019, e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosjes (LVV), me seli në Prishtinë, ndërsa koalicionit AAK/PSD, për shkak të vendosjes së tavolinës me materiale promovues dhe postera në rrugë publike, i SHQIPTOHET dënimi me gjobë në lartësi prej 5,100.00 euro (pesë mijë e njëqind) euro, të cilën gjobë subjekti politik detyrohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga pranimi i këtij vendimi, nën kërcënim të përmbarimit.

## A r s y e t i m

Me datën 03.10.2019, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se me datë 03 Tetor 2019, rreth orës 15:00, në Rrugën “15 Qershor 99”, në qytetin Gjilanit, aktivistet e këtij subjekti kanë vërejtur se aktivistet e subjektit politik AAK/PSD, kanë vendosur një tavolinë me material propagandues dhe disa postera në rrugë publike.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se ky veprim është në kundërshtim me dispozitën ligjore të nenit 33 pika b) të LZP-së, dhe po ashtu shkelje e Rregullores Nr.13/2013.

Parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, si dëshmi ka bashkangjitur disa fotografi të printuara.

Në përgjigjen në ankesë të datës 03.10.2019, koalicioni AAK/PSD, thekson se ankesa e paraqitur nga subjekti politik LVV, është tendencioze sepse në fotografi shihet qartë se kemi të bëjmë me njërën prej zyrave të AAK-së, dhe e njëjta shfrytëzohet për fushatë.

Koalicioni AAK-PSD, përgjigjes në ankesë, si provë i ka bashkangjitur disa njoftime që koalicioni në fjalë ka bërë në rrjetet sociale për anëtarët dhe simpatizantët e tij lidhur me respektimin e rregullave zgjedhore.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

### **Ankesa është e bazuar**

Paneli nga fotot e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të sigurve ka konstatuar se tavolina me material promovues është vendosur në rrugë publike, dhe postërat me kandidatet e koalicionit AAK/PSD janë të vendosura në një lokal, ndërsa në shkresat e lëndës nuk ka dëshmi se pronari i lokalit është koalicioni AAK/PSD, dhe se i njëjti lokal përdoret si zyre për fushatë zgjedhore ashtu si pohon koalicioni i sipërcituar në përgjigjen e parashtruar.

Paneli vlerëson se vendosja e tavolinës me material promovues dhe e posterave në hapësirë publike, janë veprime që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së, i cili përcakton se “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike* ”

Këtë shkelje koalicioni AAK/PSD, në përgjigjen në ankese nuk e ka mohuar shkeljen e supozuar, ndërkaq pretendimet përkitazi me pronësinë dhe veprimet e “lejuara” të koalicionit AAK/PSD, nuk i ka argumentuar me dëshmi të qarta dhe bindëse, që do të kishin ndikim në vendosjen e meritave të ankesës.

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Faktin se subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Faktin se subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se koalicioni AAK/PSD, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për t’u përgjigjur dhe ta përmirëson shkeljen në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika a) e LZP-së, mirëpo subjekti politik nuk e ka ndërmarr asnjë veprim për përmirësimin e shkeljes.

Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe pretendimet tjera përkitazi me atë se koalicioni në fjalë i ka njoftuar kandidatet dhe mbështetësit tjerë të koalicionit lidhur me shkeljen e kodit të mirësjelljes, se në këtë rast nga ana e parashtruesit të ankesës është bere abuzimin i të drejtës se ankesës. Këto parashtrime u cilësuan pa ndikim në meritat e lëndës , andaj paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika c) të LZP-së dhe nenit 3 paragrafi 2 Rregullës Nr. 01/2012, Për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobjave të PZAP-it.

Nga arsyet e theksuar me lart e në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 200/2019 më datën 05.10.2019

**Kryesuesi i Panelit**  
Gyltene Sylejmani



***Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.***